



## 5 Martesa në Zvicër

**Qëllimi:** Për personat të cilët dëshirojnë të lidhin kurorë në Zvicër me një shtetas zviceran apo me një të huaj që jeton në Zvicër me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme.

**Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.**

### DOKUMENTET E NEVOJSHME

<input type="checkbox"/> 3 formularë "Vizë D" të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.	<input type="checkbox"/> Formulari "Pyetje shitesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.
<input type="checkbox"/> Formulari "Kërkesë për përgatitje për martesë". Ky formular duhet të plotësohet paraprakisht (pa datë, pa nënshkrim).	<input type="checkbox"/> Nëse keni lindur jashtë martesës: Procesverbal për njohje atësie.*
<input type="checkbox"/> Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 4 kopje.	<input type="checkbox"/> Vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë
<input type="checkbox"/> 4 kopje të pasaportës dhe të leje qëndrimit së bashkëshortit/-es në Zvicër.	<input type="checkbox"/> Në rast të ndryshimit të emrit: Kopje e vërtetuar e procesverbalit të ndryshimit të emrit/mbiemrit.
<input type="checkbox"/> Certifikata e lindjes origjinale: lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja.	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e shkurorëzuar: Kopje e vërtetuar e vendimit të shkurorëzimit (me shënimin rreth plotfuqishmërisë) lëshuar nga gjykata. *
<input type="checkbox"/> Certifikata personale origjinale.*	<input type="checkbox"/> Nëse keni lindur jashtë martesës: Pranimi i atësisë lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile përkatëse.*
<input type="checkbox"/> Certifikata familjare origjinale.	<input type="checkbox"/> Nëse jeni i/e ve: Certifikata e vdekjes i/e bashkëshortit/-es.
<input type="checkbox"/> Certifikata për lidhje martese origjinale, e lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare.	<input type="checkbox"/> Nëse keni fëmijë të përbashkët: Certifikata e lindjes e fëmijës.

### INFORMATAT TË RENDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shitesë.
- \* Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhën shqipe duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Partneri, i cili jeton në Zvicër mund të interesohet në Qendrën e Statusit Civil përkatës për informata shitesë.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Terminet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet ne ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.



### Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminimit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: [pristina.visa@eda.admin.ch](mailto:pristina.visa@eda.admin.ch). Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për martesë**.
- **Marrja e vendimit :** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente dhe partneri në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lutemi që të paraqiteni me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të hënës deri të premten prej orës 8.00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.

### Vula apostile

Të gjitha dokumentet shqiptare duhet të jenë të pajisur me vulën apostile nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

### Pagesa

Shpenzimet për procedurën në Prishtinë janë **212 euro + 80 euro tarifa e vizës**.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

### Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- t'i dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t'i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.